



Datë: 04.09.2025
Numër Protokolli: 6119/2025

A.nr.1456/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi–Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi-në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 1456/2025 të datës 23.07.2025 e parashtruar nga ankuesja H.B, kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.09.2025, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr. 1456/2025 e datës 23.07.2025 e parashtruar nga ankuesja H.B.

A r s y e t i m

Ankuesi H.B, (tutje referuar vetëm Ankuesi), më datë 23.07.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4995, e regjistruar nën shenjen A. Nr. 1456/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor lidhur me mos përgjigje e datës 28.05.2025, të parashtruar tek Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, dhe se disa here kam kërkuar ngritjen e koeficientit sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat e Sektorit Publik, ku përmes këtij ligji zyrtaret e transportit janë paraparë me komitentë 5.3, si profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.08 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit, ndërsa Këshilli më datën 01.09.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Zyra e Kryeministrit, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4945/2025 të datës 23.07.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; emalin e dërguar nga H.B, për A.K; Kërkesën e datës 28.05.2025; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesi; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.08.2025, dërguar R. K, për N.X; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1456/2025, të datës 01.09.2025; Akt Emërimit të datës 13.11.2020, për ankuesin; Akt Emërimit të datës 08.07.2024, për ankuesin; Listën e pagave për muajin janar dhjetor të vitit 2023; Listën e pagave për muajin nëntor të vitit 2022; Listën e pagave për muajin korrik të vitit 2025; Vendimi me numër protokoll 356/2022, i datës 01.12.2022, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit; emalin e datës 04.04.2023, dërguar nga B.B. për A.F; emalin e datës 06.04.2023, dërguar nga B.B. për N.X; emalin e datës 22.10.2024, dërguar nga N.X. për A.F; emalin e datës 06.04.2023, dërguar nga N.X. për A.K; kërkesë e datës 03.12.2023; emalin e datës 25.06.2025, dërguar nga A.G. për Zyrën e Personelit; Kërkesë e datës 11.11.2024; Diplomë me numër protokoll 006/21, për H.N, e lëshuar nga Kolegji Globus; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Transportit”; Vendimi me numër protokoll Nr. 08/226, i datës 23.10.2024,

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesit, konstatoi se ankesa është e parakohshme, sepse:

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokoll 243/2024, të datës 08.07.2024, është i punësuar në Zyrën e Kryeministrit, dhe se i njëjti mbanë pozitën e punës Zyrtar i Transportit , Njësia e Transportit.

Më datë 13.07.2025 ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor lidhur me mos përgjigje e datës 28.05.2025, të parashtruar tek Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, dhe se disa here kam kërkuar ngritjen e koeficientit sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat e Sektorit Publik, ku përmes këtij ligji zyrtaret e transportit janë paraparë me komitentë 5.3, si profesional 2.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor,* Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Zyra e Kryeministrit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, (e aplikueshëm deri me datë 21.02.2024), por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohej me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 28.02.2024, thekson faktin se *institucionet janë të obliguara që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje*, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim merititor. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDAA.nr. 1456/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit H.B;
Divizionit për Burime Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit dhe
Arkivit të KPMSHCK-së